



Korçë, më 20.10. 2015

## KONTRATË BASHKËPUNIMI

E lidhur sot më datë \_\_\_\_\_ midis prindërve të klasës së \_\_\_\_\_ dhe shkollës "Raqi Qirinxi" përfaqësuar nga Drejtore e shkollës Znj.Keti Qirinxi.

### NENI 1

#### QËLLIMI I KONTRATËS

Kjo kontratë bashkëpunimi lidhet midis shkollës "Raqi Qirinxi" e prindërve, të nxënësve të klasës \_\_\_\_\_, për të realizuar misionin e rëndësishëm në rritjen e formimin e nxënësve, duke qënë pjesëmarrës aktivë të këtij bashkëpunimi për të siguruar një proces normal edukativ e arsimor në shkollë.

### NENI 2

#### BAZA LIGJORE E KONTRATËS

Kjo kontratë lidhet në bazë të ligjit Nr.69; dt.21.06.2012 si dhe Dispozitave Normative.

### Neni 3

#### KUPTIMI I TERMAVE NË KONTRATË

- "Shkolla" në kontratë nënkupton, të gjithë personelin mësimdhënës , drejtues dhe ndihmës.
- "Nxënës" në kontratë nënkupton, fëmijën e rregjistruar për të vijuar procesin mësimor në këtë shkollë.
- "Prind" në kontratë nënkupton, njërin nga prindërit e nxënësit ose edhe të dy së bashku.
- "Mësues kujdestar" në kontratë nënkupton , mësuesin e ngarkuar nga Drejtoria e shkollës , për kujdestarinë e klasës.

#### NENI 4

##### TË DREJTAT DHE DETYRAT E SHKOLLËS

- 1- Shkolla detyrohet të sigurojë për nxënësit, mjedise të sigurta dhe të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe kulturor, sipas standarteve ligjore.
- 2- Shkolla merr përsipër të zhvillojë procesin mësimor – edukativ sipas orarit të hartuar nga Drejtoria e shkollës.
- 3- Shkolla merr përsipër të realizojë me cilësi të gjitha programet mësimore të miratuara nga MAS.
- 4- Shkolla realizon të gjitha veprimet e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 5- Shkolla detyrohet të informojë prindërit për legjislacionin arsimor në fuqi, kurrikulën që institucioni i ofron nxënësve, si dhe Rregulloren e brendshme të saj.
- 6- Shkolla është e detyruar të informojë prindërit për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe edukativ të nxënësve.
- 7- Shkolla ka të drejtë të marrë masa disiplinore ndaj nxënësve, në rast të shkeljes së Rregullores së brendshme të shkollës.
- 8- Shkolla ka të drejtë të propozojë përmirësime të shërbimeve arsimore në nivel klase apo institucioni.
- 9- Shkolla ka të drejtë të miratojë akte të brendshme (rregullore etj.) për mbarëvajtjen e aktivitetit të saj, dhe në përputhje me nevojat e saj.
- 10- Shkolla merr përsipër t'u ofrojë shërbim psikosocial nxënësve e prindërve.
- 11- Shkolla merr përsipër të jetë një mjedis i hapur për të pritur bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e trekëndëshit nxënës – mësues – prindër.
- 12- Shkolla merr përsipër të nxitë e të zhvillojë talentet tek nxënësit dhe idetë kreative, të të gjithë aktorëve që marrin pjesë në procesin mësimor edukativ.
- 13- Shkolla është e detyruar të njoftojë prindërit dhe të kërkojë lejën e tij me shkrim , për veprimtari të nxënësve pas orarit mësimor ose veprimtari jashtëshkollore.

#### NENI 5

##### TË DREJTAT DHE DETYRAT E NXËNËSVE

- 1- Nxënësi ka të drejtë të kryejë veprimtarinë e tij në shkollë, në kushte të qeta dhe të sigurta për jetën dhe shëndetin.
- 2- Nxënësi ka të drejtë të trajtohet me respekt dhe dinjitet në mënyrë të kulturuar nga shkolla.
- 3- Nxënësi ka të drejtë të njihet me të drejtat dhe detyrat e tij në shkollë.
- 4- Nxënësi ka të drejtë të arsimohet dhe edukohet si dhe të ndihmohet për të përballuar vështirësi të veçanta të të nxënësve.
- 5- Nxënësi ka të drejtë t'i merren parasysh kërkesat e tij në kurrikulën me zgjedhje.
- 6- Nxënësi detyrohet të respektojë të drejtat e nxënësve të tjerë dhe të gjithë personelit mësimor dhe ndihmës në shkollë.
- 7- Nxënësi detyrohet të zbatojë me korrektësi Rregulloren e brendshme të shkollës, si dhe akte të tjera të miratuara nga Drejtoria e shkollës.

- 8- Nxënësi duhet të frekuentojë sistematikisht të gjithë procesin mësimor.
- 9- Nxënësi ka të drejtë dhe është i detyruar t'u drejtohet për ndihmë mësuesve, mësuesit kujdestar, psikologut dhe drejtorisë së shkollës për zgjidhjen e problemeve që e shqetësojnë.
- 10-Nxënësi duhet të respektojë rregullat e shkollës për mbrojtjen e shëndetit, të sigurisë e të mjedisit dhe të kërkojë respektimin e tyre nga nxënësit e tjerë dhe punonjësit arsimorë.

## NENI 6

### TË DREJTAT DHE DETYRAT E MËSUESIT KUJDESTAR

#### 1- MËSUESI KUJDESTAR DETYROHET TË NJOHË PRINDËRIT ME:

- a) Kushtet shëndetësore dhe të sigurisë në institucion.
- b) Dispozitat ligjore me të drejtat dhe detyrat e prindërve, nxënësve dhe personelit mësimor.
- c) Rregulloren e brendshme të shkollës apo akte të tjera të miratuara nga Drejtoria e shkollës për nevojat e saj .
- d) Kurrikulën me zgjedhje.
- e) Proçedurat e zhdëmtimeve.
- f) Proçedurat e ankimit.

#### 2- MËSUESI KUJDESTAR DUHET:

- a) Të infotmojë prindërit për mbarëvajtjen e fëmijëve të tyre.
- b) Të informojë në veçanti prindërit e nxënësve me vështirësi në të nxënë, apo me sjellje shqetësuese ose me problem në ndjekjen e shkollës.
- c) Të nxitë interesin e prindërve për mbarëvajtjen e procesit mësimor –edukativ si dhe të nxitë përfshirjen e tyre në këtë proces.

#### 3- MËSUESI KUJDESTAR DUHET TË INFORMOJË PRINDËRIT PERIODIKISHT NË LIDHJE ME ECURINË E NXËNËSVE, FREKUENTIMIN, SI DHE SJELLJEN E NXËNËSVE.

- a) Në takimet mujore.
- b) Në takimet simestrale.

#### 4- Mësuesi është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit për çdo nxënë, duke vënë në dispozicion atë vetëm prindit të nxënësit.

#### 5- Mësuesi kujdestar shkëmben informacion me prindërit për nxënësit duke vendosur kontakte nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit si telefon, email etj.

## NENI 7

### TË DREJTA DHE DETYRA TË PRINDËRVE

#### 1- Prindi ka të drejtë të informohet:

- a) Për legjislacionin në fuqi, për kurrikulën që shkolla i ofron fëmijës, dhe rregullin e brendshëm të institucionit.

- b) Për kushtet e sigurisë të shëndetit dhe mjedisit të shkollës dhe të kërkojë përmbushjen e tyre sipas standarit.
- c) Me masat disiplinore të specifikuara në Rregulloren e brendëshme procedurat e ankimit dhe procedurat e zhdëmtimeve
- d) Ka të drejtë të propozojë përmirësime të shërbimit arsimor në nivel klase apo shkolle.
- e) Ka të drejtë të bashkëpunojë me shërbimin psiko-social në shkollë.

2) PRINDI KA PËR DETYRË:

- a) Të kujdeset për mbarëvajtjen e fëmijës së tij në procesin mësimor.
- b) Të njoftojë mësuesin kujdestar për ndryshime të shëndetit e sjellje të fëmijës së tij .
- c) Të marrë pjesë në takimet periodike mujore apo simestrale në shkollë.

d) Të zhdëmtojë materialisht të gjitha dëmet që fëmija i tij shkakton në shkollë të bazës material apo mjeteve mësimore dhe didaktike.

**NENI 8**

**KOHËZGJATJA E KONTRATËS**

Kjo kontratë lidhet me nënshkrimin e saj dhe zgjidhet me përfundimin e ciklit të plotë shkollor..

**NENI 9**

**NDRYSHIMI I KONTRATËS**

Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me vullnetin e të dy palëve nënshkrues.

**Neni 10**

**KJO KONTRATË FILLON TË ZBATOHET ME NËNËSHKRIMIN E SAJ NGA PALËT.**

**PËR KLASËN \_\_\_\_\_**

**PRINDËRIT BASHKËLIDHUR LISTA EMËRORE**

**PËR SHKOLLËN**

**DREJTORE**

**Keti QIRINXHI**



e-mail: [shkollaraqirinxhi@yahoo.com](mailto:shkollaraqirinxhi@yahoo.com)

Tel: [++355 82 242929](tel:+35582242929)

Tel: [++355 8224](tel:+3558224)

